



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE**

**SHPALLJE PËR LEVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIMIN NË
SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE
(SPECIALIST/E)**

**Lloji i diplomës “Shkenca Shoqërore”
Niveli minimal i diplomës “Master shkencor”**

Në zbatim të neneve 22 dhe 23, të Ligjit 152/2013, “për nëpunësin civil”, si dhe të Kreut II, IV dhe VI, të Vendimit nr.143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

1(një) specialist/e i/e marrredhënieve me publikun dhe i/e redaktimit gjuhësor, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë në administratën e Gjykatës Kushtetuese-kategoria IV-A(ish III-B).

Pozicioni më sipër u ofrohet nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se për këtë pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant ai është i vlefshëm për konkurim nëpër-mjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat(lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Data e fillimit të njoftimit:	05 shtator-2014
Data e mbarimit të njoftimit:	03 nëntor-2014
Data e fundit e dorëzimit të dokumentave:	04 tetor-2014

**Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë tërë të dyja procedurat.*

Përshkrimi pergjithësues i punës për grupin e pozicionit si më sipër është:

Vendi i punës në pozicionin “specialist i/e marrëdhënieve me publikun dhe i/e redaktimit gjuhësor” bën pjesë në grupin e administrimit të posaçëm. Ai/ajo përgjigjet para drejtorit të drejtorise së Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë dhe jep hollësi për plane pune dhe plane veprimi e nisma për arritjen e objektivave në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata lidhur me marrëdhëniet me publikun dhe redaktimin gjuhësor për sa më poshtë:

- Të kontribuojë për organizimin e mbajtjen e marrëdhënieve me shtypin, mediat vizive etj.
- Të studiojë dhe informojë për problemet që lidhen me drejtësinë, veprimtarinë gjyqësore e posaçërisht për Gjykatën Kushtetuese në shtypin e përditshëm, mediat vizive etj.
- Të japë hollësi për komunikata, njoftime apo konferenca shtypi në mjetet e informimit publik për veprimtarinë e gjykatës.
- Të japë hollësi dhe të ndjekë korespondencën jo gjyqësore për kërkesat drejtuar institucionit nga individë, e subjekte të ndryshme shoqërore, private, etj.
- Të kontribuojë për realizimin e procesit të redaktimit gjuhësor të projekt-vendimeve, teksteve dhe akteve të tjera zyrtare të Gjykatës Kushtetuese.
- Të ofrojë një shërbim redaktimi gjuhësor me profesionalizëm të lartë për nxjerrjen e akteve zyrtare në përputhje me rregullat bashkëkohore të drejtshkrimit gjuhësor dhe fjalorit shqip.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

1) Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

Kandidatët për lëvizjen paralele duhet të plotësojnë kushtet si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një document nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë një diplomë të nivelit “Master shkencor” në shkencat shoqërore në degen gjuhe-letërsi shqipe ose gazetari.
- Nota mesatare e rezultateve në studimet universitare të jete 8.0, e lart.
- Prioritet përbën edhe një diplomë e dytë universitare në drejtësi e nivelit “Bachelor” ose titull shkencor sipas kategorisë së vëndit të punës.

- Të ketë përvojë pune të paktën 5 vjet në institucione të një rangu në redaktimin gjuhësor të akteve ligjore e nënligjore dhe vendimeve gjyqsore.
- Te zotërojë me dëshmi një nga gjuhët e huaja të BE(anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe italisht) të mbrojtur me provim në institucione të arsimit të lartë, liçensuar ose TOEFL-in, brënda afatit të vlefshmërisë së certifikatës së lëshuar.
- Te zotërojë me dëshmi, metodat e reja të informacionit dhe të ketë aftësi shumë të mira të përdorimit të PC-se në programet baze operative të tij.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

2) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese dokumentat e mëposhtme:

- a) Leter motivimi për aplikim në vendin e lire të punës me një numër kontakti dhe adresën e plotë të vëndbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail-i për komunikim.
- b) Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- c) Fotokopje e diplomës. Nëse kandidati disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë atë të njëjësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- d) Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë kandidati duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- e) Fotokopje e librezës së punës.
- f) Vërtetimi i gjëndjes gjvqësore ose formulari i plotësuar për lejimin e kontrollit të gjëndjes gjyqsore në mënyrë elektronike nga institucioni.
- g) Fotokopje e letërnjoftimit(karta e identitetit).
- h) Vërtetim të gjëndjes shëndetsore(raport mjeko-ligjor nga komisioni i qëndrës ku banon)
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brënda datës 04.10.2014.

3) Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën 08.10.2014, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore(Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore) e Gjykatës Kushtetuese do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim dhe do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të të Gjykatës Kushtetuese(www.gjk.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista. Kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfa-betik.

Në të njëjtën datë do të njoftohen kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e lëvizjes paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të vecantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet nga DEKBNj-ja e cila njofton në menyre individuale, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit(DEKBNj-së), brënda 3(tre) ditëve pune nga data e shpalljes së listës. Ankuesi merr përgjigje brënda 3(tre) ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.

4) Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese;
- Ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”;
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003, “Për rregullat e etikes në administratën publike;
- Kodin e Proçedurave Administrative;
- Ligjin nr.8503, date 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Rregulloren e Brëndshme të Gjykatës Kushtetuese;

5) Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

Kandidatët do të vlerësohen nga “Komisioni i brendshëm”, i ngritur pranë institucionit të Gjykatës Kushtetuese. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 40 pikë për dokumentacionin dhe 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, përvojat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive sipas dokumentacionit të dorëzuar i ndarë si më poshtë:

- 10 pikë jetëshkrimi;
- 10 pikë për eksperiencën;
- 5 pikë për trajnimet;
- 10 pikë për kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse;
- 5 pikë për vlerësimet pozitive.

Kandidatët për intervistën e strukturuar me gojë do të vlerësohen me 60 pikë në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Përvojën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Më shumë detaje në lidhje me metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.4, datë 13.08.2014, DAP dhe faqen zyrtare të saj: www.dap.gov.al.

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

6) Afatet, data e nxjerrjes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit.

Konkurimi-intervista e strukturuar me gojë do të bëhet në datën 20.10.2014, në mjediset e Gjykatës Kushtetuese, në orën 10-00.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore(Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore) e Gjykatës Kushtetuese do të shpallë listen e fituesve me mbi 70 pikë(mbi 70% të pikëve) në datën 19.11.2014.

Njoftimi do të bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese(www.gjk.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut, në datën 23.10.2014.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numrin e telefonit 4 2243 698 ose në adresën: Gjykata Kushtetuese, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.26,Tiranë.

II-Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive

Vetëm në rast se për pozicionin e publikuar në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se nuk ka fitues, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Ky informacion do të merret në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese(www.gjk.gov.al), duke filluar nga data 23.10.2014.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit nr.152/2013

1) Kushtet për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit nr.152/20103.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë një diplomë të nivelit “Master shkencor” në shkencat shoqërore ne degen gjuhe-letërsi shqipe ose gazetari.
- Nota mesatare e rezultateve ne studimet universitare te jete 8.0, e lart.
- Prioritet përbën edhe një diplomë e dytë universitare në drejtësi e nivelit “Bachelor”ose titull shkencor sipas kategorisë së vëndit të punës.
- Të ketë përvojë pune të paktën 5 vjet në institucione të një rangu në redaktimin gjuhësor të akteve ligjore e nënligjore dhe vendimeve gjyqsore.
- Te zotërojë me dëshmi një nga gjuhët e huaja të BE(anglisht, frengjisht, gjermanisht dhe italisht) të mbrojtur me provim në institucione të arsimit të lartë, liçensuar ose TOEFL-in, brënda afatit të vlefshmërisë së çertifikatës së lëshuar.
- Te zotërojë me dëshmi, metodat e reja të informacionit dhe të ketë aftësi shumë të mira të përdorimit te PC-se ne programet baze operative të tij.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

2) Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë Ekonomike dhe të Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese dokumentat e mëposhtme:

- a) Leter motivimi per aplikim ne vendin e lire te punes me një numër kontakti dhe adresën e plotë të vëndbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail-i për komunikim.
- b) Jetëshkrimi i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- c) Fotokopje e diplomës. Nëse kandidati disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëhere ai duhet ta ketë atë të njëhsuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.
- d) Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëhere kandidati duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- e) Fotokopje e librezës së punës.
- f) Vërtetimi i gjëndjes gjvqësore ose formulari i plotësuar per lejimin e kontrollit të gjëndjes gjyqsore në mënyrë elektronike nga institucioni.
- g) Fotokopje e letërnjoftimit(karta e identitetit).
- h) Vërtetim të gjëndjes shendetsore(raport mjeko-ligjor nga komisioni i qëndrës ku banon)
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- j) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brënda datës 04.10.2014.

3) Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën 24.10.2014, por jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimin të aplikimit(listës së fituesve të procedurës së lëvizjes paralele), njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore(Drejtoria Ekonomike dhe e Burimeve Njerëzore) e Gjykatës Kushtetuese do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim dhe do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Gjykatës Kushtetuese(www.gjk.gov.al) dhe në kendin e njoftimeve publike të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista. Kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik.

Në të njëjtën datë do të njoftohen kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e lëvizjes paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë në të cilën regjistrohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk publikohet dhe administrohet nga DEKBNj-ja e cila njofton në menyrë individuale, nëpërmjet adresës të e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë njësise së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit(DEKBNj-së), brënda 5(pesë) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës. Ankuesi merr përgjigje brënda 5(pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të ankesës.

4) Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin e funksionimin e Gjykatës Kushtetuese;
- Ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”;
- Ligjin nr.9131, date 08.09.2003, “Për rregullat e etikes në administratën publike;
- Kodin e Proçedurave Administrative;
- Ligjin nr.8503, date 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”;
- Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Rregulloren e Brëndshme të Gjykatës Kushtetuese;

5) Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

Kandidatët do të vlerësohen nga “Komisioni i Përhershëm i Pranimit”(KPP), i ngritur pranë institucionit të Gjykatës Kushtetuese.

Në datën 25.10.2014, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese dhe në këndin e njoftimeve të publikut të institucionit. Këta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër.

Konkurimi-testimi me shkrim do të bëhet në datën 31.10.2014, në mjediset e Gjykatës Kushtetuese, në orën 10-00.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- Vlerësimi i jetëshkrimit – 15 pikë;
- Intervista e strukturuar me gojë – 15 pikë;
- Testimi me shkrim – 70 pikë.

Pas përfundimit të vlerësimit të testit me shkrim, kur kandidati merr mbi 40 pikë e lart, ai i nënështrohet intervistës së strukturuar me gojë.

Më shumë detaje në lidhje me metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.4, datë 13.08.2014, DAP dhe faqen zyrtare të saj: www.dap.gov.al.
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

Lista e fituesve me mbi 70 pikë(mbi 70% të pikëve) do të shpallet në datën 03.11.2014. Njoftimi do të bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës Kushtetuese dhe në këndin e njoftimeve publike të institucionit. Për sqarime, mund të kontaktoni me numrin e telefonit 4 2243 698 ose në adresën: Gjykata Kushtetuese, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.26,Tiranë.

GJYKATA KUSHTETUESE

Tirane, me, 05.09.2014

LIDHJA 1

LISTA E DOKUMENTAVE QE DUHET TE PLOTESOJE KANDIDATI

- 1) -Leter motivimi per aplikim ne vendin e lire te punes.
- 2) -Nje kopje Jeteshkrimi(CV).
- 3) -Nje numer kontakti dhe adresen e plote te vendbanimit te shoqeruar me nje adrese aktive e-mail-i per komunikim.
- 4) -Fotokopje e diplomes. Nese aplikanti disponon nje diplome te nje universiteti te huaj, atehere ai duhet ta kete te njehsuar ate prane ministrise pergjegjese per arsimin.
- 5) -Fotokopje e listes se notave. Nese ka nje diplome dhe liste notash te ndryshme me vleresimin e njohur ne Shtetin Shqiptar, atehere aplikanti duhet ta kete te konvertuar ate sipas sistemit shqiptar.
- 6) -Nje kopje te librezes se punes e plotesuar.
- 7) -Vertetimi i gjendjes gjvqesore.
- 8) -Vërtetim të gjëndjes shendetsore(raport mjeko-ligjor nga komisioni i qëndrës ku banon)
- 9) -Çertifikata te kualifikimeve, trajnimeve te ndryshme.
- 10) -Deshmi te njohjes se nje gjuhe te huaj.
- 11) -Fotokopje e leternjofitimit(karta e identitetit).